



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT •

Nr. 186 prot

Datë: 03.04.2017

**NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORË TË PROGRAMEVE LËNDORË PËR  
KLASËN E XII-të**

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, mbështetur në nevojën për hartimin me cilësi të programeve lëndore për klasën e XII –të për Reformimin e Kurrikulës së Gjinnazit kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm konkretisht për këto programe lëndore:

- Gjuhë Shqipe (Bërthamë)
- Letërsi (Bërthamë)
- Letërsi (Me zgjedhje)
- Gjuhë e huaj e parë (Bërthamë)
- Gjuhë e huaj e dytë (Me zgjedhje)
- Matematikë (Bërthamë)
- Matematikë (E avancuar)
- Fizikë ( Me zgjedhje)
- Kimi (Me zgjedhje)
- Biologji (Me zgjedhje)
- Sociologji (Me zgjedhje)
- Psikologji (Me zgjedhje)
- Ekonomi (Me zgjedhje)
- Histori (Me zgjedhje)
- Gjeografi (Me zgjedhje)
- Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti (Bërthamë)
- Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti (Me zgjedhje)
- TIK (Me zgjedhje)
- Teknologji (Me zgjedhje)

*Hartuesit e programeve duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:*

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë për lëndën përkatëse.

2. Të kenë një eksperiencë pune jo më pak se pesë vjeçare në mësimdhënie dhe të jenë mësimdhënës aktiv në ciklin për programin e të cilit kërkohet bashkëpunimi.
3. Të kenë përvojë paraprake në punën për analizën, vlerësimin dhe zhvillimin e kurrikulave (standarde, programe etj..), në nivel qendror ose vendor.
4. Të kenë marrë pjesë si bashkëpunëtorë të IZHA-s në projekte ose veprimtari që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave.
5. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushën e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të kurrikulës në nivel qendror ose vendor.
6. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

**Kandidatët për hartues të programeve duhet te dorëzojnë CV-në e tyre pranë sekretarisë së Institutit të Zhvillimit të Arsimit, brenda datës 10.04.2017, ora 16.00.**

*Faleminderit!*